



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.97/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve [“A...”], me seli në Zvicër, të cilën e përfaqëson [“I...”] nga Prishtina e sipas autorizimit [G.D], kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“S...”] me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim [A.N], për shkak të rimbursimit të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses dhe të paditurës të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.196/16 të datës 10/12/2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **30/12/2020**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e paditëses Kompania e Sigurimeve [“A...”], me seli në Zvicër dhe të paditurës Kompania e Sigurimeve [“S...”] me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike V.EK.nr.196/16 të datës 10/12/2019, përveç në pjesën që ka të bëjë me kamatën në të cilën pjesë **NDRYSHOHET** dhe vendoset ashtu që **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve [“S...”] me seli në Prishtinë, që paditëses Kompania e Sigurimeve [“A...”], me seli në Zvicër, t’ia paguajë kamatën ligjore në shumën e gjykuar prej 8 %, duke llogaritur nga data 06/08/2015 e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin ankimor V.EK.nr.196/16 të datës 10/12/2019, ka vendosur si vijon: I. Aprovohet tërësisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve [“A...”], me seli në Zvicër, e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“S...”] me seli në Prishtinë, ashtu që:

II. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve [“S...”] me seli në Prishtinë, që në emër të regresit paditësit t’ia kompensoj shumën në lartësi prej

3,919.21 €, të gjitha me kamatë ndëshkuese prej 8 % në vit, duke filluar nga data e dhënies së këtij aktgjykimi (10.12.2019), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcenim të përmbarrimit me dhunë.

III. Detyrohet e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1,109.28 €.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësja në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovojë ankesën si të bazuar dhe të ndryshojë aktgjykimin e atakuar në pikën II, ashtu që të detyrohet e paditura që të paguajë kamatëvonesën prej 12% në vit duke filluar nga data 06/08/2015 si dhe shpenzimet e kontestit në shumë prej 2,345.28 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar sa i përket shpenzimeve të procedurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesat janë të pa themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Kompania e Sigurimeve ["A..."], me seli në Zvicër, pranë Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 05/04/2016, ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ["S..."] me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që nga baza e sigurimit të auto-përgjegjësive nga rasti i siguruar i datës 21/07/2014 t'ia rimburojë kasko regresin paditëses në shumën prej 10,599.96 euro me kamatë ndëshkuese prej 12%, duke filluar nga data 06/08/2015 e deri në pagesën definitive si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore ndërsa i autorizuari i paditëses në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 10/12/2019 e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në shumë prej 3,919.21 euro.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka miratuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke arsyetuar se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte

kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë se deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur me fajin primar të sigurvearit të paditurës në shkallë prej 75 % dhe me fajin sekondar të sigurvearit të paditëses në shkallë prej 25%, i cili fakt është vërtetuar me ekspertizën e komunikacionit të punuar nga [B.L]. Mandej, në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar theksohet se në bazë të ekspertizës së makinerisë të punuar nga grupi i ekspertëve në përbërje prej A.K], [SH.L] dhe [H.D] rezulton se lartësia e dëmit në automjetin e sigurvearit të paditëses, arrin vlerën prej 5,225.62 euro. Gjykata e shkallës së parë ia ka falur besimin ekspertizës së makinerisë të punuar nga grupi i ekspertëve, ngase ekspertiza përmban elementet e nevojshme të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsyeve të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerëson si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore dhe mbi bazën e kësaj gjendje faktike ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 281 dhe nenin 305 lidhur me nenin 382 par. 2 dhe nenin 960 par.1 të LMD-së, nenin 25 dhe nenin 26 të Ligjit për Sigurimet e Detyrueshme nga Auto Përgjegjësia ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marr konform nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2, pika n) të LPK, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe mbi bazën e saj, drejt e ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 960 par.1 të LMD-së, me të cilën dispozitë

është përcaktuar se: “me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”, me ç’rast paditësja ia ka paguar të siguruarit të saj kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar te paditësja. Në mes palëve ndërgjyqese nuk ishte kontestuese baza juridike dhe as lartësia e kërkesëpadisë, dhe në këtë drejtim nuk kishte pretendime ankimore.

Gjykata e Apelit i ka shqyrtuar pretendimet tjera ankimore të paditëses dhe të paditurës lidhur me aplikimin e kamatë vonesës, por të njëjtat i ka vlerësuar si të pa bazuara, për arsye se par.7 i nenit 26 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Auto Përgjegjësia, përjashton zbatimin e kamatës prej 12% për regresim borxhi, kamatë kjo e paraparë vetëm për mostrajtim dhe rënie në vonesë të trajtimit të kërkesave të personave të dëmtuar për dëmshpërblim. Lidhur me pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të atakuar sa i përket datës së rrjedhjes së kamatës, Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale, ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, dhe ka vendosur që rrjedhja e kamatës ligjore të fillon nga data 06/08/2015, kur është paraqitur kërkesa në procedurë jashtë gjyqësore, ngase e paditura nga kjo datë ka rënë në vonesë kur nuk e ka përmbushur detyrimin brenda afatit, deri në pagesën definitive.

I drejtë del te jetë edhe vendimi për shpenzimet e procedurës, pasi që shpenzimet e njohura janë në përputhje të plotë me shpenzimet që i njëjti i ka pasur rreth përfaqësimit të tij në procedurë dhe kanë qenë të nevojshme për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

-Departamenti për Çështje Ekonomike-

Ae.nr.97/20, me datën 30/12/2020

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku, d.v